



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh II.nr. 1303/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Bageri 1” Sh.p.k., me numër unik identifikues 811048851 dhe seli në Gaçkë, Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.H., avokate nga Prishtina, kundër debitorit “Toifor” Sh.p.k., me numër unik identifikues 810484890 dhe seli në Prishtinë, lagja Emshir, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Bageri 1” Sh.p.k., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Toifor” Sh.p.k., me numër unik identifikues 810484890, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 9/2022, i lejuar me datë 18.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, për pjesën e detyrimit në shumën prej EUR 14,673.00. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit “Toifor” Sh.p.k., me numër unik identifikues 810484890, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 8,500.00, së bashku me kamatë vonesën prej 8% në vit, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr. 9/2022, i lejuar me datë 18.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se kreditori me ankesë nuk ka arritur të dëshmoj se faturat e përshkruara si në propozimin për përbarim i janë dërguar përbaruesit privat në origjinal ose kopje të vertetuara nga origjinali ashtu siç e kërkojnë dispozitat e LPP-së. Andaj ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë, që të refuzoj në tërësi ankesën e e debitorit dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Bageri 1” Sh.P.K., me dt. 18.01.2022 ka paraqitur propozim për përbarim mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturës nr. 29, e datës 05.12.2019; Faturës nr. 35, e datës 19.12.2019; Faturës nr. 23, e datës 24.09.2020, si dhe; Faturës nr. 48, e datës 06.11.2020, ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 9/2022, të datës 18.01.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 23,173.00, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e në emër të përpilimit të propozimit për përbarim, në vlerë prej EUR 208.00, sipas rregullores mbi tarifatat e avokatëve.

Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.9/2022 dt. 18.01.2022, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin për lejimin e përbarimit për shkak se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar

urdhri përmbartimor janë dorëzuar në kopje dhe rrjedhimisht nuk i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 36 të LPP-së. Ka shtuar faturat e lëshuara nga kreditori nuk mbështeten në asnjë lloj kontrate apo marrëveshjes mes palëve, ndërsa ka kontestuar edhe kërkesën për pagesën e kamatës ligjore ngase e njejta nuk është e specifikuar në dokumentin përmbartimor. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditore, në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri është lejuar në bazë të dokumenteve të besueshme dhe se detyrimi i mbetur i debitorit mbi bazën e këtyre dokumenteve është në lartësi prej EUR 23,173.00. Ka shtuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pabazuara, për faktin se kreditore propozimit për përmbartim ia ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e besueshme në origjinale dhe se të njëjtat gjenden në shkresa të lëndës. Ndërsa, për pretendimet lidhur me kamatëvonesë, kreditore ka theksuar se e njejta është e përcaktuar me dispozita të LMD-së, dhe se mbi këtë bazë është kërkuar edhe pagesa e kamatëvonesës në lartësi prej 8%. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk gjen mbështetje në nenin 69.4 dhe 71 të LPP-së, ngase nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore për paraqitjen e prapësimin. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1931/22 të datës 17.08.2023, ku në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Toifor” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810484890, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 9/2022, i lejuar me datë 18.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, për pjesën e detyrimit në shumën prej EUR 14,673.00. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit “Toifor” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810484890, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 8,500.00 së bashku me kamatëvonesën prej 8% në vit, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr. 9/2022, i lejuar me datë 18.01.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbanimor 9/2022, i lejuar me datë 18.01.2022, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori në vlerë prej 14,673.00 euro, dhe atë sipas Faturës nr. 29, e datës 05.12.2019, Faturës nr. 23, e datës 24.09.2020, si dhe Faturës nr.48, e datës 06.11.2020, ngase këto fatura nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumentet të përshtatshme për përmbanim, për arsye se kreditori nuk i ka deponuar faturat në fjalë në origjinale apo kopje të vërtetuar, ashtu siç përcaktohet me nenin 37 të LPP-së, sipas së cilit: *“Kur propozimi për përmbanim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr. 9/2022, të datës 18.01.2022, për shumën në vlerë prej EUR 8,500.00, sipas faturës nr. 35, e datës 19.12.2019, ngase në vlerësimin e gjykatës kjo faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, ngase në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Për më tepër, gjykata gjen se e njëjta faturë i është dorëzuar me rregull debitorit i cili të njëjtën e ka pranuar duke e nënshkruar dhe vulosur, dhe rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen dhe detyrimin që buron nga këto fatura.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbanimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbanimor për pjesën e borxhit prej 14,673.00€, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbanimi nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuar ashtu siç përcaktohet me nenin 37 të LPP-së, sipas së cilit: *“Kur propozimi për përmbanim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbanim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 37 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbartimor në shumën prej 8,500 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të kreditorit kur ka theksuar se në ankesë ka bashkangjitur faturat të cilat janë të noterizuara por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi që me shikim në shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se kreditori në ankesë ka bashkangjitur vetëm kopjet e faturave, pra nuk ka arrit ti argumentoj se faturat i ka dorëzuar në origjinal apo të noterizuara me prova juridikisht të vlefshme. Në rastin konkret faturat nuk janë në origjinal ashtu sipas dispozitës së lartëcekur dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbartimore, mirëpo kreditori mund të inicioj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij varësisht sipas suksesit në atë procedurë. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1303/23 me datë 19.03.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija- Ymeri